



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-23218/23 datë:23.08.2023



Npi – 01/306 datë: 31.08.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.08.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 31.08.2023, (e enjte) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtorët, Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi, zyrtari për mardhanje me publikun, z.Bajrush Rrahmani, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Nga RZSH, z.Muhamet Hoxha, Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, nga Koha Ditore z.Agim Ademi, praktikantët, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 31.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Raporti buxhetor për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023,
4. Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
5. Diskutim për raportin vjetor të Auditorit të Brendshëm për Auditimet dhe Aktivitetet e brendëshme të kryera gjatë periudhës prej 01.01 deri 31.12.2022,
6. Diskutim për Raportin e Auditorit të Jashtëm për pasqyrat vjetore të Komunës së Shtimes për vitin 2022,
7. Prezantimi i Planit Buxhetor 2024-2026,
8. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).
9. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore,

10. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për Diskutim Publik),

11. Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, këto pika mendoj se nuk do të votohen, për arsye se mbledhja e fundit nuk ka përfunduar, sepse nuk ka pas kourum. Ne kërkojmë që të vazhdojmë me pikën e rendit të ditës që ka ngelë pa u përfunduar informatë nga DKA-ja, e pastaj të vazhdojmë.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, pikat e rendit të ditës nuk kanë ardhur sipas planit dhe ashtu qysh jemi dakorduar. Nuk na ka ardhur pika e informatës për arsim, arsyen ne nuk e dimë. Ka qenë premtim i juaji Kryesues për me na thirrë dhe me diskutuar paraprakisht për zgjedhjen e një anëtarit të KPF-së por ju e keni anashkaluar. Unë propozoj që të futet si pikë shtesë.

z.Përparim Ramusa; Në emër të grupit parlamentar të PDK-së kjo mbledhje nuk do të vazhdojë, sepse mbledhja e fundit nuk ka përfunduar, dhe ti Kryesues nuk na ke thirrë për me vazhdu mbledhjen. Pastaj edhe drejtorët nuk kanë qenë në shumicën e rasteve prezent në mbledhje për me na dhënë sqarime, edhe te Komitetet nuk po marrin pjesë drejtorat. Nuk është prezantuar kërkesa e Ramiz Kadriut për sa i përket ndërtimit të një shtëpie për pleq. Shoqata "Katari" e ka ndërpre bashkëpunimin pikërisht për shkak të mos bashkëpunimit të Komunës me këtë shoqatë, ndërsa Komunitet tjerë kanë përfituar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sa i përket propozimit për futjen e pikës shtesë për zgjedhjen e anëtarit të KPF-së unë e mabjë premtimin dhe mund ta votojmë si pikë shtesë. Unë si Kryesues i Kuvendit në mbledhjen e fundit të mbajtur më 06.07.2023 e kam përfunduar mbledhjen, për arsye se e para janë shterrë të gjitha diskutimet, e dyta kjo pikë nuk ka pas nevojë me u votuar sepse ka qenë informatë. Mirëpo nëse ka propozim për me e futë si pikë shtesë ne mund ta qesim në votim.

z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, KKSBB-ja duhet të raportoj në çdo 6 muaj, pse nuk e keni futë edhe këtë si pikë e rendit të ditës. Në këtë pikë është dashur të diskutohet edhe për elementin e sigurisë, turizmit si dhe për shumë elemente tjera, p.sh. në fshatin Dugë e keni lënë vetëm atje një investitorë një patriotë që ka dhënë shumë për këtë vend dhe nuk ka përkrahje. Pse nuk është raporti i KKSBB-së?

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë pajtohem plotësisht me këtë rend dite. Sa i përket propozimit për informatën e arsimit unë nuk pajtohem sepse është diskutuar mjaftë gjatë për të në mbledhjen e fundit dhe nuk ka pasur diskutime tjera prandaj edhe Kryesuesi e ka mbyllë seancën, ashtu kështu kjo informatë nuk duhej të votohej. Ne jemi të obliguar që të punojmë për nevojat e qytetarëve e që realisht ata po presin prej neve me i qu projektet përpara.

z.Reshat Mujota; Asnjë pikë të rendit të ditës nuk e kemi sipas planit të punës, këtu kemi krejt pika tjera. Problemi i zgjidhjes së anëtarit të KPF-së tash prapë po kërkohet me u futë si pikë e rendit të ditës. Edhe unë propozoj që zgjedhja e anëtarit të KPF-së të jetë si pikë shtesë e rendit të ditës dhe ta shohim se kush po e voton.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, në mbledhjen e fundit unë kam qenë prezent deri në fund, nuk ka pas Kuorum. Materiali i Kuvendit nuk na ka ardhur me kohë, nuk duhet me ardhë materiali 12 orë përpara. Ti Kryesues e ke shkelë rregulloren kur e ke mbyllë mbledhjen pa Kuorum. Unë jam që ajo pikë informata e DKA-së duhet me u përfunduar sepse nuk ka qenë në rregull.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, unë po e shohë si shqetësim mjaftë të madhë faktin se PDK-ja në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa është pajtuar dhe e ka votuar rendin e ditës mu kështu si është këtu në Kuvend dhe nuk ka pasë asnjë vërejtje, e këtu në Kuvend po del krejt diçka tjetër. Tu kisha lutë Kryesues që fillimisht me qitë në votim rendin e ditës ashtu siç është propozuar nga ju, e pastaj me propozime.

z.Përparim Ramusa; Kadri, nuk mundet KPF-ja me votu rendin e ditës për Kuvendin, pastaj këtu ka edhe pika tjera shtesë.

z.Rexhep Gashi; Në bazë të rregullores të punës së Kuvendit ne kemi mundësi me futë vetëm një pikë shtesë të rendit të ditës e jo dy pika. Mbledhja e kaluar ka përfunduar por pikat nuk kanë përfunduar, prandaj ju Kryesues po bëni gabime që nuk po i qitni pikat për diskutim. Pyetja për ju Kryesues është: A

kanë përfunduar pikat e rendit të ditës në mbledhjen e kaluar? Ndoshta Zyrtari Ligjorë mundet me na dhënë shpjegime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e dhashë sqarimin më parë për këtë çështje se në mbledhjen e fundit të mbajtur më 06.07.2023 e kam përfunduar, për arsye se e para janë shterrë të gjitha diskutimet, dhe e dyta kjo pikë nuk ka pas nevojë me u votuar sepse ka qenë informatë.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë po dëgjojë me vëmendje sepse kam qenë anëtare e Komisionit për hartimin e rregullores së punës. Unë po kërkojë nga ti Kryesues që me respektu rregulloren. Mbledhja e fundit nuk ka përfunduar, ndërkaq drejtoresha për shkakë të pa përgjegjësisë duhet me dhënë dorëheqje.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, debati mundet me zgjatë deri në 12 orë, por e rëndësishme është me theksu se mbledhja e fundit nuk ka përfunduar, edhe ashtu unë kam shumë vërejtje për sa i përket këtyre pikave të rendit të ditës.

z.Reshat Mujota; Kërkojë falje që për herë të dytë po e marrë fjalën. Në vazhdim, lexoi pikat e parapara me Planin e Punës. Siç po e shihni në Planin e Punës prapë e kemi të paraparë si pikë të rendit të ditës Informatë nga DKA për përgaditjet e fillimit të vitit të ri shkollorë 2023-2024. Zakonisht kur përfndon mbledhja e Kuvendit numërohen anëtarët prezent të Kuvendit se a ekziston Kourumi. Zyrtari Ligjorë le të na spjegon a ka përfunduar mbledhja?

z.Lulzim Muharremi, Zyrtar Ligjorë; Përshëndetje, çështja gati e njejtë ka ndodhur edhe më parë. Kryesuesi e ka përfunduar mbledhjen, mirpo pikat e mbetura vazhdojnë në mbledhjen e radhës. Se a kanë përfunduar pikat apo jo ju vendosni vetë.

z.Lumni Amrushi; Po e sqaroj pyetjen pak më mirë pyetja është: A mundet Kryesuesi me e mbyllë mbledhjen e Kuvendit pa Kuorum?

z.Lulzim Muharremi, Zyrtar Ligjorë; Mbledhjen Kryesuesi e mbyllë, nëse nuk ka pika të tjera për shqyrtim. Nëse ka pika tjera ato barten për mbledhjen e radhës. Për pikat që ka përfunduar diskutimi nuk barten në mbledhjen e radhës.

z.Besnik Seferi; Mua po më duket absurde me këto diskutime, që po stërzgjaten, kur Zyrtari Ligjorë e sqaroi shumë mirë çështjen e përfundimit të mbledhjes. Drejtoresha e DKA-së në mbledhjen e fundit ka dhënë dy orë sqime dhe është përgjigjur në të gjitha pyetjet e asambleistëve, diskutimet kanë qenë në fund, pasi që nuk ka pas të interesuar tjerë për diskutime shumica e anëtarëve të Kuvendit kanë dalë nga mbledhja jo për shkakë të bojkotit por duke e pa se diskutimet janë shterrur. Megjithatë unë jam “për” nëse doni prapë me futë si pikë shtesë kështu që mund të diskutojmë sa të doni.

z.Përparim Ramusa; Zyrtari Ligjorë tha se pikat e pa përfunduara mund të barten në mbledhjen e radhës. Pse nuk po vazhdohet me informatën, kështu në këtë formë unë nuk jam për me vazhdu mbledhjen.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kourimin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës me 10 vota “Për”, me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse nuk u miratua rendi i ditës ashtu siç është propozuar atëherë unë po e hedhi në votim propozimin e z.Rexhep Gashit dhe z.Reshat Mujotës që për pikë shtesë të futet edhe pika “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri”.

***Kuvendi i Komuës me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 9 vota “Abstenim” e miratoi rendin e ditës me pikën shtesë si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 31.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Raporti buxhetor për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023,
4. Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
5. Diskutim për raportin vjetor të Auditorit të Brendshëm për Auditimet dhe Aktivitetet e brendëshme të kryera gjatë periudhës prej 01.01 deri 31.12.2022,

6. Diskutim për Raportin e Auditorit të Jashtëm për pasqyrat vjetore të Komunës së Shtimes për vitin 2022,
7. Prezantimi i Planit Buxhetor 2024-2026,
8. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).
9. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore,
10. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për Diskutim Publik),
11. Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve,
12. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri. (Pikë Shtesë)

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 31.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Ne si grup parlamentar i PDK-së në shenjë pa knaqësie e lëshojmë mbledhjen e Kuvendit, për arsye të shkeljes së rregullores të punës së Kuvendit.


Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi se grupi parlamentar i PDK-së prej 9 anëtarëve të Kuvendit e lëshuan mbledhjen e Kuvendit në ora 10:10h. Meqenëse Kourumin e kemi prej 12 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje ne mund të vazhdojmë tutje me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

z.Reshat Mujota; Këtu po luhet një lojë, në të cilën unë nuk dua me ra në këso lojnash. Ne e kemi votuar anëtarin e KPF-së, dhe nëse KPF-ja vjen në këtë gjendje, unë nuk mundem me qëndru, sepse unë jam zgjedhë si anëtarë i KPF-së dy herë. Vendimi është kthyer nga Ministria për shkak të kuotës gjinore. Kryesuesi ka dhënë premtim se gjatë muajit Gusht do të takohemi dhe do ta zgjedhim këtë problem, mirëpo, unë nuk jam ftuar për ta diskutuar këtë çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë po jap 5 minuta pauzë në ora 10:15h dhe po e bisdojmë sepse mendoj se këtë çështje mund ta zgjidhim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vazhdojë mbledhjen në ora 10:50h, duke sqaruar se anëtarët e Kuvendit Reshat Mujota dhe Rexhep Gashi u deklaruan që ta shtyjmë mbledhjen për kohë të pa caktuar deri sa ta gjejmë një zgjidhje. Për vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit do të njoftoheni me kohë pasi ta kemi gjetur një zgjidhje. Kryesuesi mbledhjen e mbylli në ora 10:54h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

